



Nr. 921/5 prot.

Tiranë, më 30.03.2022

**VENDIM**

Nr. 26 , datë 30.03.2022

**“PËR MIRATIMIN E PËRJASHTIMIT NGA TARIFA E SHKOLLIMIT SIPAS  
KRITERIT EKONOMIK, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022, PËR STUDENTEN  
ELISA DOCI, E CILA STUDION NË NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË  
PARË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, e ndryshuar, Bordi i Administrimit, pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 725/1 prot., datë 17.03.2022 “Mbi miratimin e kërkesës së një studenti për përjashtim nga tarifa e shkollimit sipas kriterit ekonomik për vitin akademik 2021-2022”, në mbledhjen e datës 30.03.2022,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë përjashtimin nga tarifa e shkollimit, sipas kriterit ekonomik, për vitin akademik 2021-2022 për studenten Elisa Doci, e cila studion në një program studimi të ciklit të parë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqjen zyrtare të internetit të UMT-së.

**KRYETAR  
ZAMIRA GJINI**

**ANËTARË**

**MONIKA FIDA**

**VERA OSTRENI**

**ALTINA XHAFERI**

**ALBANA GJINOPULLI**

**ANIS THODHORJANI**

**ENDRIT YZEIRAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Nr 545/16 Prot

Tiranë më 28/02/2022

**Lënda :** Lista shtesë e studentëve që përfitojnë Përjashtim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2021-2022

Në mbështetje të proces verbalit Nr.545/15 Prot, Datë 28.02.2022 në lidhje me shqyrtimin e kërkesës së studentes Elisa Doci për rishikimin e përfitimit për Përjashtim nga tarifa shkollimit për vitin akademik 2021-2022”, është si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Dega në të cilën Studion	Viti shkollimit
	Studentë përfitues sipas kriterit "Që kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Fakultetit të Aftësisë së Kufizuar për Përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar"		
1	Elisa Doci	Higjenist Dentare	I

Efekti financiar fillon që në fillim të vitit akademik 2021 – 2022.

**Sqarojmë** se nga verifikimi i dokumentacionit të studentes Elisa Doci është fituese për vitin akademik 2021 – 2022, pasi në proces verbalin Nr. 545/4 Prot, Dt 14.12.2021 rezulton fituese ndërsa në listën e përfituesve Nr.545/5 Prot, Datë 14.12.2021 (hartuar mbi bazën e proces verbalit) gabimisht është shënuar dy herë studentja Silva Bicaku.

**Komisioni**

1.Ajete Osmanaj

2.Diana Hoxha

3.Lorena Qafnolla